



Amnistimi i kriminalitetit përmes parashkrimit



Autor: Lavdim Makshana


Redaktor: Gzim Shala

Me kontribut të: Florian Smajli dhe Blerta Barku

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi Prishtinë

E: info@kli-ks.org www.kli-ks.org

www.kli-ks.org

**Dhjetor, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës**

Lista e Shkurtesave

IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
RFSSL	Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Sundimit të Ligjit
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DS	Departamenti Special
GJThP	Gjykata Themelore në Prishtinë
PThP	Prokuroria Themelore në Prishtinë
DP	Departamenti i Përgjithshëm
DKR	Departamenti i Krimeve të Rënda
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PSh	Prokurori i Shtetit

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	5
2. Nocioni i parashkrimit	6
3. Dukuria e parashkrimit në Kosovë	7
4. Parashkrimi	8
4.1.Parashkrimi i korrupsionit	8
4.2.Parashkrimi i krimeve të politikanëve	8
5. Arsyet e parashkrimit të rasteve gjyqësore sipas monitorimit të IKD-së	10
6. Mungesa e llogaridhënies për rastet e parashkruara	12
7. Ngritja e aktakuzave dhe vendosja në prag të parashkrimit	12
7.1.Ngritja e aktakuzave në prag të parashkrimit	12
7.2.Vendosja në prag të parashkrimit pamundëson atakimin në Supreme	13
8. Rekomandime	14
9. Rastet e politikanëve që janë parashkruar dhe që rrezikojnë të parashkruhen 2023-2026	15
10. Rastet e korrupsionit të parashkruara në vitin 2023	17
11. Rastet e korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen më 2024	18
12. Rastet e korrupsionit që rrezikojnë të parashkruhen 2025-2026	19

1. Përmbledhja ekzekutive

Një nga sfidat kryesore që e ka sfiduar sistemin e drejtësisë penale në Kosovë në një periudhë dis-avjeçare është parashkrimi i madh i lëndëve. Numri i rasteve të parashkruara ka shpërfaqur një çështje problematike në të gjitha aspektet e drejtësisë penale në vend.

Përkundër faktit se me planifikimet në letër dhe me strategji të ndryshme të KGJK-së dhe KPK-së çështjet e korrupsionit duhet të trajtohen me prioritetin absolut, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në praktikë gjatë viteve, për shkak se një numër i madh i lëndëve gjatë viteve janë vjetërsuar, duke pamundësuar gjykimin meritore. Nga monitorimi që IKD i bën sistemit të drejtësisë, është gjetur se faktorët që ndikojnë në parashkrimin e rasteve penale, me theks të veçantë atyre të korrupsionit, bëjnë pjesë në dy kategori: objektive dhe rrethanat apo arsyt subjektive. Sa i përket arsyeve objektive, numri i madh i lëndëve, mungesa e gjyqtarëve, mungesa e stafit administrativ, e të tjera, janë disa nga arsytet të cilat ndikojnë në zvarritjen e trajtimit të rasteve të korrupsionit, e cila zvarritje shkon deri në parashkrim të këtyre rasteve.

IKD në raportin “Parashkrimi i korrupsionit”, kishte evidentuar se gjatë vitit 2023 rrezikonin të parashkruhen rastet e 24 të akuzuarve, të cilët bënë pjesë në 18 raste gjyqësore. Ky paralajmërim duket se deri në një pikë ka rezultuar i suksesshëm, kjo pasi gjatë këtij viti janë parashkruar rastet e shtatë (7) të akuzuarve të cilët janë të përfshirë në pesë (5) raste gjyqësore. Pra, 17 të akuzuar më pak sesa kanë rrezikuar të parashkruheshin. Nëse kalkulohet dëmi i pretenduar nga prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2023 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 142 mijë e 817 euro. Mirëpo, kjo vlerë është llogaritur vetëm për dy (2) raste, ndërsa për tre (3) raste nuk është llogaritur pasi prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin e pretenduar në aktakuzë. Kështu, përkundër pamjaftueshmërisë, të dhënat flasin për progres në këtë fushë. Pasi nga 18 raste gjyqësore sa rrezikonin të parashkruheshin gjatë vitit 2023, janë parashkruar vetëm pesë (5) raste. Ndërsa në vitin 2022, ishin parashkruar 16 raste me 28 persona. Më 9 dhjetor 2023 rrezikon të parashkruhet edhe një rast gjyqësor i korrupsionit.

Përkundër kësaj, parashkrimi do të jetë problem edhe në vitet pasuese, kjo pasi gjatë vitit 2024 rrezikojnë të parashkruhen rastet e 20 të akuzuarve, e që përfshijnë 14 raste gjyqësore. Dëmi i kalkuluar sipas aktakuzave të Prokurorive, rezulton të jetë 582 mijë e 872 euro e 87 centë. Parashkrimi siç duket do të jetë problem edhe në vitet pasuese, pasi në tri vitet e ardhshme ka rrezik potencial që të parashkruhen rastet e afro 100 të akuzuarve.

IKD ka monitoruar në vazhdimësi edhe rastet gjyqësore të politikanëve, të cilët kanë probleme me ligjin. Sa i përket parashkrimit të rasteve të politikanëve, IKD gjen se në vitin 2023 është parashkruar një rast gjyqësor, e që është rasti ndaj ministrit të Punëve të Brendshme (MPB), Xhelal Sveçla. Ndërsa, janë edhe tetë (8) politikanë, rastet e të cilëve për disa vepra rrezikojnë të parashkruhen në tri (3) vitet e ardhshme.

2. Nocioni i parashkrimit

Instituti i Parashkrimit- është njëri nga institutet më të rëndësishme në të drejtën penale. Parashkrimi është një koncept i rëndësishëm, i cili ndikon që një person i caktuar të mos mund të ndiqet penalisht apo të gjykohet me arritjen e një afati të caktuar ligjor. Me parashkrim vendosen kufijtë kohor për ndjekjen apo gjykimin e një personi të caktuar për një vepër penale të një natyre të caktuar. Kjo do të thotë se koha e përcaktuar për parashkrim është e përcaktuar me ligj dhe në momentin kur arrihet afati i parashkrimit, ndjekja penale nuk mund të zhvillohet, e nëse e njëjta është duke u zhvilluar në momentin e arritjes së këtij afati, procedura duhet të ndërprehet. Arritja e afatit të parashkrimit ka për pasojë mbetjen e pagjykuar në mënyrë meritore të personave të akuzuar. Për parashkrimin e ndjekjes penale, institucionet e sistemit të drejtësisë kujdesen sipas detyrës zyrtare. Kështu, pa marrë parasysh ekzistimin e kërkesës së të pandehurit, në secilin rast kur ka arritur afati i parashkrimit i ndjekjes penale, institucionet nuk duhet t'a fillojnë ndjekjen penale, respektivisht duhet ta pushojnë ndjekjen penale.¹

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) ka përcaktuar afatet e parashkrimit, varësisht dënimit të përcaktuar me ligj. Ky Kod njih dy lloj afatesh të parashkrimit: relativ dhe absolut. Me parashkrim relativ nënkuptojmë vonesën e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të ndërmarrë veprimet e caktuara procedurale, për të cilat arsye parashkruhet edhe ndjekja penale. Ndërsa, me parashkrim absolut nënkuptojmë kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale deri në momentin kur vepra penale parashkruhet. Në rastin e dytë, veprimet e institucioneve të drejtësisë nuk janë relevante në raport me afatin e parashkrimit. Afati i parashkrimit absolut është më i gjatë sesa ai relativ.²

Arritja e afatit të parashkrimit amnistion kryerësit potencial të veprave të ndryshme penale. Por, në të njëjtën kohë ky afat dëmton dhe ka pasoja në jetën e personave të akuzuar padrejtësisht e të cilët mbahen “peng” i drejtësisë dhe në fund nuk mund të merret një aktgjykim për rastet e tyre, duke i lënë ato raste të vjetërsohen dhe ta arrijnë parashkrimin.

Kodi i ri Penal që kishte hyrë në fuqi në prill të vitit 2019 ka zgjatur në masë të konsiderueshme afatet e parashkrimit. Instituti i Kosovës për Drejtësi (Tutje: IKD) kishte vlerësuar se zgjatja e afatit të parashkrimit nuk paraqet zgjidhje të drejtë dhe proporcionale për trajtimin e rasteve të korrupsionit. Sipas IKD-së, në sistemin e drejtësisë duhet të fuqizohen kapacitetet institucionale për të trajtuar brenda afateve të arsyeshme veprat penale të korrupsionit. Mungesa e këtyre kapaciteteve nuk duhet të shkojë në dëm të sigurisë juridike të qytetarëve.³

1 Salihu I. Zhitija H. dhe Hasani F. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”. Botimi 1. Prishtinë. Mars 2014. Faqe 329-330. (Qasur për herë të fundit më 23 tetor 2023).

2 Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 99-100.

3 Gashi L. dhe Shala G. “Korrupsioni në prag të vjetërsimit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2021. Faqe 5-6. (Shih linkun: (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

3. Dukuria e parashkrimit në Kosovë

Dukuria e parashkrimit në Kosovë ka qenë vazhdimisht një dukuri shqetësuese në sistemin kosovar të drejtësisë. Numri i madh i lëndëve të parashkruara gjatë viteve, ka qenë problematikë në të gjitha fushat e drejtësisë penale në Kosovë. E po ashtu, shumë më shqetësuese ka qenë parashkrimi i rasteve të korrupsionit. Parashkrimi i rasteve të korrupsionit edhe përkundër prioritizimit të këtyre rasteve me strategji të ndryshme përgjatë viteve, ka treguar që ky fenomen sërish mbetet problem pa një adresim adekuat. Parashkrimi i rasteve të korrupsionit në disa raste është konsideruar edhe si amnistim i korrupsionit.⁴

Se parashkrimi ishte edhe në të kaluarën një dukuri shqetësuese në fushën penale, tregon më së miri edhe dokumenti i politikave “*Ekzekutimi i sanksioneve penale*”, dokument ky i dalë nga Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL).⁵ Një dokument tjetër i dalë nga ky proces, thekson se “[m]onitorimi gjeti se gjatë vitit 2018, lëndët e korrupsionit në gjykatat e Kosovës janë parashkruar, madje edhe ato të shënjuara për liberalizim të vizave”.⁶ Gjatë viteve 2015-2019, në Gjykatat Themelore janë parashkruar aktakuzat ndaj 50 personave apo 4.56% e lëndëve të zgjidhura.⁷ Gjetjet e IKD-së, flasin për mosefikasitet të theksuar në trajtimin e rasteve të korrupsionit, ku si rrjedhojë gjatë vitit 2022 janë parashkruar rastet ndaj 28 të pandehurve të akuzuar për korrupsion, e që në total ishin 16 lëndë të korrupsionit.⁸ Problematika e parashkrimit ishte evidencuar edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për vitin 2022, ku ishte cituar raporti i IKD-së.⁹

Duke i'u referuar raportit të IKD-së për parashkrimin e korrupsionit gjatë vitit 2022, anëtarët e KGJK-së kishin kërkuar që rastet e korrupsionit të trajtohen me prioritet.¹⁰

4 “Iustitia 2 – Amnistia e korrupsionit përmes vjetërsimit të lëndëve”. Iustitia. 08 maj 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/iustitia-amnistia-e-korrupsionit-permes-vjetersimit-te-lendeve-2/>). (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

5 “Dokumenti i Politikave mbi ekzekutimin e sanksioneve penale”. Ministria e Drejtësisë. Prishtinë. Nëntor 2019.

6 Rishikimi funksional i sundimit të ligjit në Kosovë. “Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial”. Ministria e Drejtësisë. Faqe 24

7 Gashi L. dhe Shala G. “Korrupsioni në prag të vjetërsimit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2021. Faqe 5-6. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Korrupsioni-ne-prag-te-vjetersimit-Final.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

8 “Parashkrimi i Korrupsionit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2022. Faqe 4. (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

9 “2022 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo”. U.S Department of State. Mars 2023. (Shih linkun: <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>). (Qasur për herë të fundit më 30 tetor 2023).

10 “Raporti i IKD-së për parashkrimin e korrupsionit diskutohet në mbledhjen e KGJK-së, anëtarët kërkojnë që këto lëndë të trajtohen me prioritet”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2022. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/raporti-i-ikd-se-per-parashkrim-in-e-korrupsionit-diskutohet-ne-mbledhjen-e-kgjk-se-anetaret-kerkojne-qe-keto-lende-te-trajtohen-me-prioritet/>. (Qasur për herë të fundit më 30 tetor 2023)

4. Parashkrimi

4.1. Parashkrimi i korrupsionit

IKD në raportin e vitit 2022 mbi parashkrimin e korrupsionit, kishte evidentuar se janë parashkruar rastet e 28 të pandehurve të akuzuar për vepra penale korruptive, ku në total rastet e këtyre 28 të akuzuarve bënë pjesë në 16 lëndë gjyqësore.¹¹ Në këtë raport, pos evidentimit të rasteve të parashkruara, IKD tërhoqi vëmendjen e rrezikimit për parashkrim edhe të rasteve të tjera, duke evidentuar datat e sakta të rasteve të korrupsionit, të cilat ishin në proces. Pas publikimit të këtij raporti, viti 2023 ka rezultuar dukshëm më i suksesshëm në luftën kundër parashkrimit të rasteve të korrupsionit. Kjo pasi IKD në raportin *“Parashkrimi i korrupsionit”*, kishte evidentuar se gjatë vitit 2023 rrezikonin të parashkruhen rastet e 24 të akuzuarve, të cilët bënë pjesë në 18 raste gjyqësore. Ky paralajmërim duket se deri në një pikë ka rezultuar i suksesshëm, kjo pasi gjatë këtij viti janë parashkruar rastet e shtatë (7) të akuzuarve të cilët janë të përfshirë në pesë (5) raste gjyqësore.¹² Pra, 17 të akuzuar më pak sesa kanë rrezikuar të parashkruheshin. Ndërsa, në vitin 2023, rrezik potencial për parashkrim ka edhe rasti i Shaban Gallopenit i cili parashkruhet me 9 dhjetor 2023.¹³

Nëse kalkulohet dëmi i pretenduar nga prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2023 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 142 mijë e 817 euro. Mirëpo, kjo vlerë është llogaritur vetëm për dy (2) raste, ndërsa për tre (3) raste nuk është llogaritur pasi prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin e pretenduar në aktakuzë.

Kështu, përkundër pamjaftueshmërisë, të dhënat flasin për progres në këtë fushë. Pasi nga 18 raste gjyqësore sa rrezikonin të parashkruheshin gjatë vitit 2023, janë parashkruar vetëm pesë (5) raste. Ndërsa në vitin 2022, ishin parashkruar 16 raste me 28 persona. Përkundër kësaj, parashkrimi do të jetë problem edhe në vitet pasuese, kjo pasi gjatë vitit 2024 rrezikojnë të parashkruhen rastet e 20 të akuzuarve, e që përfshijnë 14 raste gjyqësore. Dëmi i kalkuluar sipas aktakuzave të Prokurorive, rezulton të jetë 582 mijë e 872 euro e 87 centë. Parashkrimi siç duket do të jetë problem edhe në vitet pasuese, pasi në tri vitet e ardhshme ka rrezik potencial që të parashkruhen rastet e afro 100 të akuzuarve.

4.2. Parashkrimi i krimeve të politikanëve

IKD nga monitorimi sistematik që i bën sistemit të drejtësisë, ka evidentuar në vitet e mëhershme trajtim joefikas të rasteve të politikanëve nga gjyqësori dhe mosrespektim të afateve ligjore. IKD ka konsideruar se kjo qasje e gjyqësorit krijon një perceptim negativ tek publiku për mungesë të guximit të trajtimit të rasteve të politikanëve nga ana e gjykatave, veçanërisht, nëse rastet e të njëjtëve parashkruhen.¹⁴ Se rastet e politikanëve nuk po trajtohen me efikasitet, e tregon edhe rasti ndaj kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, të cilit gjatë vitit 2022 i ishte

¹¹“Parashkrimi i Korrupsionit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2022. Faqe 4. (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

¹² Po aty.

¹³ Shënim: Një nga rastet ka rrezik për parashkrim me 9 dhjetor 2023.

¹⁴ Thaqi M.: “Sfidat në trajtimin e krimeve të përgjithshme”. Prishtinë. Korrik 2022. Fq. 6-9.

parashkruar një vepër penale, por që parashkrimi ishte konstatuar tek në vitin 2023. Vepra penale e parashkruar rezulton të jetë *“Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”*. Ndryshe, për këtë rast Konjufca po akuzohet edhe për veprën penale *“Përdorim i armës”*. Ky rast është duke u gjykuar nga gjykatësja e Departamentit të Përgjithshëm, Edita Çanta.¹⁵

IKD ka monitoruar në vazhdimësi edhe rastet gjyqësore të politikanëve të cilët kanë probleme me ligjin.¹⁶ Sa i përket trajtimit të këtyre rasteve gjyqësore ku janë të përfshirë politikanë, IKD kishte gjetur se këto raste po përcjellen me zvarritje shumë më të madhe sesa zvarritjet që hasen në rastet e tjera ku janë të përfshirë qytetarë të rëndomtë, e që disa raste për shkak të zvarritjeve kanë arritur parashkrimin absolut.¹⁷ Sa i përket parashkrimit të rasteve të politikanëve, IKD gjen se në vitin 2023 është parashkruar një rast gjyqësor, e që është rasti ndaj ministrit të Punëve të Brendshme (MPB), Xhelal Sveçla, i cili ishte i akuzuar për veprën penale *“Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm”*.¹⁸ Lidhur me zvarritjet dhe parashkrimin e këtij rasti, një ndër arsyetimet e gjykatës kishte qenë mungesa e të pandehurve në seanca.¹⁹ Ndryshe, *“Betimi për Drejtësi”*, kishte njoftuar paraprakisht se ky rast do të arrinte parashkrimin.²⁰ Ky rast ishte gjykuar nga gjykatësi i Departamentit të Përgjithshëm (DP), Eroll Gashi.²¹

Ndërsa, janë edhe tetë (8) politikanë, rastet e të cilëve për disa vepra rrezikojnë të parashkruhen në tri (3) vitet e ardhshme. Këtu bëjnë pjesë shtatë (7) deputetë, katër (4) prej të cilëve vijnë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, dy (2) deputetë vijnë nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe një nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). (Shih grafikën më poshtë).

15“Konjufcës i parashkruhet vepra penale për pengim të personit zyrtar”. Betimi për Drejtësi. 25 tetor 2023.

(Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/adem-grabovci-nuk-me-kujto-het-qe-ndonjehere-glauk-konjufca-ka-hedhur-gaz-lotsjelles/?fbclid=IwAR3hbnEHCE7yHj-gFggYw8io7Z4wJDrbfddtLByolt5T6B2KN0BvwNxAt62Y>).

(Qasur për herë të fundit më 28 tetor 2023).

16 “Qeverisja me duar të pastërta”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Dhjetor 2022.

17 “Hetimet e mangëta dhe gjykimet e imëta”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Shtator 2023.

18 Kur gjykata dhe gjyqtari dështojnë, Ministrit Sveçla dhe të tjerëve iu parashkruhen veprat penale”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kur-gjykata-dhe-gjyqtari-deshtojne-ministrit-svecla-dhe-te-tjereve-iu-parashkruhen-veprat-penale/>). (Qasur për herë të fundit më 29 tetor 2023).

19 “Parashkrimi i veprave penale ndaj ministrit Sveçla dhe të tjerëve, Gjykata arsyetohet me mungesën e të pandehurve në seanca”. Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2023 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/parashkrimi-i-veprave-penale-ndaj-ministrit-svecla-dhe-te-tjereve-gjykata-arsyetohet-me-mungesen-e-te-pandehurve-ne-seanca/>). (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

20 “Kur gjykata dhe gjyqtari dështojnë, Ministrit Sveçla dhe të tjerëve iu parashkruhen veprat penale”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kur-gjykata-dhe-gjyqtari-deshtojne-ministrit-svecla-dhe-te-tjereve-iu-parashkruhen-veprat-penale/>). (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023).

21 Thaqi M.: “Sfidat në trajtimin e krimeve të përgjithshme”. Prishtinë. Korrik 2022. Fq.15,16,17.

5. Arsyet e parashkrimit të rasteve gjyqësore sipas monitorimit të IKD-së

Nga monitorimi që IKD i bën sistemit të drejtësisë, është gjetur se faktorët që ndikojnë në parashkrimin e rasteve penale, me theks të veçantë atyre të korrupsionit, bëjnë pjesë në dy kategori: **objektive** dhe rrethanat apo arsyt **subjektive**.

Një nga arsyt objektive që ndikon në parashkrimin e rasteve gjyqësore, është **mbingarkesa me lëndë e sistemit gjyqësor**. Në fund të nëntë (9) mujorit të vitit 2023, kanë mbetur mbi 268 mijë e 476 lëndë. Lidhur me numrin e madh të lëndëve të pazgjdhura, Strategjia për Sundimin e Ligjit në Kosovë, ka theksuar se ky numër i madh i lëndëve të pazgjdhura krijon vonesa të shumta procedurale.²² Po ashtu, arsye tjetër objektive që IKD ka evidentuar, janë rastet kur zvarritjet e procedurave krijohen për shkak të faktit se **i pandehuri është në arrati dhe nuk mund të gjendet**, kur palët kanë **probleme shëndetësore apo situata të tjera të kësaj natyre**.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur edhe një varg arsyesh subjektive që ndikojnë në parashkrimin e lëndëve të korrupsionit. Njëra nga to dhe më kryesorja mbetet **mosprocedimi i lëndëve gjyqësore brenda afateve të caktuara ligjore**. Me qëllim të garantimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor, i cili gjykim në parim pamundëson parashkrimin e lëndëve, Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar afatet kohore të hetimit dhe gjykimit.²³ Po ashtu, trajtim me prioritet i lëndëve të korrupsionit dhe lëndëve që rrezikojnë parashkrimin është dhënë edhe me Strategjinë e KGJK-së për prioritizim të lëndëve, e sipas kësaj strategjie lëndët që rrezikojnë parashkrimin duhet të trajtohen brenda një afati sa më të shkurtër kohor.²⁴ E që prioritet ka qenë edhe në vitet e kaluara, por që realisht prioriteti ka mbetur vetëm si obligim në letër e jo zbatim në praktikë.

Mosprocedimi adekuat i lëndëve nga gjyqtarët është njëra ndër arsyt kryesore të parashkrimit. Rast ilustrues për këtë është rasti, ndaj ish-drejtorit të Drejtorisë Komunale të Inspektorateve në Komunën e Prizrenit, Bujar Nerjovaj. Edhe përkundër që IKD kishte njoftuar se rasti do të arrinte parashkrimin në shkurt 2023, sërish ky rast nuk kishte arritur të marrë epilog. Vepra penale në këtë rast është kryer në vazhdimësi që nga vitit 2011 deri më 21 shkurt 2013. Aktakuza në këtë rast ishte ngritur tek pas pesë (5) vitesh. Pra, qysh në fillim ishin humbur pesë vite nga Prokuroria. Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë ishte marrë në kohë rekorde nga Gjykata Themelore në Prizren, pra më 3 qershor 2019, trajtim i njëjtë nuk i ishte bërë këtij rasti edhe në rigjykim, kjo pasi

22 Qeveria e Republikës së Kosovës, "Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026", Korrik 2021. F. 12 dhe 22. (Shih linkun <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 25 tetor 2023).

23 Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 157, neni 234, neni 236 dhe neni 310.

24 Shënim: KGJK me 31 maj 2022 ka miratuar Planin Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 lidhur me efikasitetin dhe prioritizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor, ku sipas këtij plani përkatësisht tek Kapitulli VI, pika 1,1 thuhet se: "Sa i përket lëndëve të fushës penale - që rrezikojnë parashkrimin, gjyqtarët duhet të kujdesen që të trajtohen brenda afatit sa më të shkurtër, duke u kujdesur që seancat të mbahen brenda një periudhe të caktuar kohore dhe të jenë të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes, mos trajtimi i lendeve të cilat rrezikojnë parashkrimin ndikon në dëmtimin e imazhit të sistemit të drejtësisë në njërin anë dhe në anën tjetër ndikon edhe në besimin e qytetarëve dhe palëve në sistemin e drejtësisë".

Gjykata në Prizren nuk kishte arritur ta përfundojë këtë rast as për më shumë se 3 vite e 2 muaj apo për 1 mijë 169 ditë. Ky rasti arriti parashkrimin më 21 shkurt 2023.²⁵

Tutje, një prej arsyeve që ndikon në parashkrimin e rasteve është kthimi i shpeshtë i rasteve në rigjykim nga Gjykata e Apelit apo ajo Supreme. Pastaj, kthimi i rasteve në pikën zero për shkak të kalimit të mbi tre (3) muaj nga seanca e fundit apo për shkak të ndërrimit të anëtarit të trupit gjykues.²⁶ Vetëm gjatë vitit 2022, IKD identifikoi gjithsej 23 raste të cilat duhej të ktheheshin në pikën zero.²⁷ Ndërsa, në vitin 2023 ishin evidentuar 17 raste, 14 prej të cilëve për shkak të ndërrimit të anëtarit të trupit gjykues. Zbatimi i dispozitës së Kodit të Procedurës Penale për gjyqtarin zëvendësues, do të ishte zgjidhje optimale që ndryshimi i trupit gjykuese mos të ndikonte në kthimin e rasteve në pikën zero.²⁸

Edhe administrimi jo i mirë i seancave gjyqësore është një ndër faktorët që ndikon në arritjen e afatit të parashkrimit të lëndëve gjyqësore. Sipas monitorimit të IKD-së, nga 685 seanca të monitoruara deri më 1 nëntor 2023, 172 seanca janë shtyrë, apo shprehur në përqindje 25% e tyre. Për këtë, IKD në raportet e kaluara kishte rekomanduar mbajtjen e seancave bllok, në atë mënyrë që për një rast të caktuar, të mbaheshin seancat çdo ditë për një periudhë të caktuar kohore, ashtu që ky veprim do të rezultonte që një numër i konsiderueshëm i rasteve do të gjykoreshin brenda një periudhe të shkurtër kohore.²⁹ Ky rekomandim ka filluar të zbatohet nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë.³⁰

25 "Ish-drejtorit të Prizrenit më 21 shkurt i vjetërsohet lënda për korrupsion, IKD paralajmëroi për rrezikun e parashkrimit të këtij rasti". Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtorit-te-prizren-it-me-21-shkurt-i-vjetersohet-lenda-per-korrupsion-ikd-paralajmeroi-per-rrezikun-e-parashkrimit-te-ketij-rasti/>). (Qasur për herë të fundit më 31 tetor 2023).

26 Shënim: Me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale afati prej tre (3) muajsh, ka ndryshuar dhe tani me Kodin aktual kthimi i rasteve në pikën zero ndodh kur kanë kaluar gjashtë (6) muaj nga seanca e fundit. (Neni 307, par 3).

27 Shala G & Makshana L "Dështimi i Drejtësisë në luftimin e korrupsionit". Prishtinë. Fq. 21.

28 Shënim: Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 284: "Nëse parashihet se shqyrtimi gjyqësor do të zgjasë, kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës të caktojë një gjyqtar për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor në mënyrë që të zëvendësojë anëtarët e trupit gjykues në rast se nuk mund të marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor. Ky gjyqtar quhet gjyqtar zëvendësues".

29 "Parashkrimi i Korrupsionit". IKD. Prishtinë. Dhjetor 2022. Faqe 7. (Qasur për herë të fundit më 28 tetor 2023).

30 "Gjykata Themelore në Prishtinë fillon caktimin e bllok-seancave siç kishte rekomanduar Instituti i Kosovës për Drejtësi". Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-ne-prishtine-fillon-caktimin-e-blok-seancave-sic-kishte-rekomanduar-instituti-i-kosoves-per-drejtesi/>). (Qasur për herë të fundit më 28 tetor 2023).

6. Mungesa e llogaridhënies për rastet e parashkuara

Për rastet të cilat parashkruhen si rrjedhojë e administrimit jo të mirë nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet të iniciohen procedura disiplinore nga Autoritetet Kompetente dhe ndaj tyre duhet të shqiptohen masa disiplinore nga KGJK dhe KPK. Por, që fatkeqësisht edhe pse gjatë viteve parashkruhen shumë raste gjyqësore, për parashkrimin e tyre ka mungesë të inicimit të procedurave disiplinore. Kjo, duke pasur parasysh se janë parashkuar edhe numër i madh i lëndëve të korrupsionit.

Si pozitive, mund të konsiderohet standardi që ka vendosur KGJK lidhur me shqiptimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve që për një kohë të gjatë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim procedural në një lëndë gjyqësore, edhe kur të njëjtit kanë pasur mundësi të bëjnë këtë.³¹ Rasti ilustrues është rasti ndaj gjyqtarit të Krimeve të Rënda, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Naser Foniqi, të cilit pas emisionit të **“Betimit për Drejtësi”** i ishte shqiptuar sanksion disiplinor, pasi për afro pesë (5) vite nuk kishte caktuar asnjë seancë e as nuk kishte marrë asnjë veprim procedural në një rast për fajde.³²

Një praktikë e tillë, duhet të ndiqet edhe në rastet e korrupsionit dhe po ashtu ky standard duhet të aplikohet edhe nga KPK.

7. Ngritja e aktakuzave dhe vendosja në prag të parashkrimit

7.1. Ngritja e aktakuzave në prag të parashkrimit

Mosveprimi dhe mosreagimi me kohë i prokurorisë mund të ketë për pasojë parashkrimin e veprave penale dhe amnistimin e kryerësve të këtyre veprave. Ngritja e aktakuzave në prag të parashkrimit të veprës penale, e kufizon gjykatën që brenda një kohe shumë të shkurtër ta përfundojë rastin e korrupsionit.

IKD ka gjetur se Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2023, ka ngritur një aktakuzë në prag të parashkrimit. Këtë aktakuzë e ka ngritur Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ndaj të akuzuarit Haxhimet Ferati, i cili akuzohet se në cilësinë e menaxherit të Zyrës së Prokurimit Publik në Komunën e Mitrovicës, ka keqpërdorur pozitën zyrtare, duke i krijuar përfitim operatorit NTP ‘Tropik’ në vlerë prej 220

31 “3 vite e mbajti në sirtar një vendim e nuk ua dërgoi kopjen palëve, KGJK i ul pagën për 4 muaj gjyqtarës Afijete Sada-Gllogjani”. Betimi për Drejtësi. 18 prill 2023. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/3-vite-e-mbajti-ne-sirtar-nje-vendim-e-nuk-ua-dergoj-kopjen-paleve-kgjk-i-ul-pagen-per-4-muaj-gjyqtar-es-afijete-sada-gllogjani/>).

“U konstatua se tri lëndë të kthyera në rigjykim u zvarritën, KGJK i ul pagën për 40% për 6 muaj gjyqtarës Labinot Zeka”. Betimi për Drejtësi. 31 tetor 2023. (Qasur për herë të fundit më 31 tetor 2023).

(Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/u-konstatua-se-tri-lende-te-kthyera-ne-rigjykim-u-zvarriten-kgjk-i-ul-pagen-per-40-per-6-muaj-gjyqtar-es-labinot-zeka/>). (Qasur për herë të fundit më 31 tetor 2023).

32 “Pas hulumtimit të “Betimit për Drejtësi”, KGJK i shqipton vërejtje publike me shkrim gjyqtarit Naser Foniqi se zvarriti për afro 5 vite lëndën e fajdesë”.

Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-hulumtimit-te-betim-it-per-drejtesi-kgjk-i-shqipton-verejtje-publike-me-shkrim-gjyqtarit-naser-foniqi-se-zvarriti-per-afro-5-vite-lenden-e-fajdeses/>).

(Qasur për herë të fundit më 31 tetor 2023).

mijë euro.³³ Kjo aktakuzë rezulton të jetë ngritur më 2 tetor 2023, ndërsa vepra penale dyshohet se është kryer më 19 nëntor 2014, pra para nëntë (9) vitesh. Kallëzimi penal në PTh në Mitrovicë sipas aktakuzës ishte pranuar më 11 korrik 2019. Kjo Prokurori kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve më 4 tetor 2021. Që nga pranimi i kallëzimit penal deri tek aktvendimi për fillim të hetimeve kishin kaluar mbi dy (2) vite apo 816 ditë. Ndërsa, deri në ngritjen e aktakuzës mbi katër (4) vite apo 1 mijë e 544 ditë. Kurse, nga aktvendimi për fillimin e hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës kishin kaluar afro dy (2) vite apo 728 ditë.

Përkundër se rastet e korrupsionit konsiderohen si lëndë me prioritet, PSh nuk e ka trajtuar këtë rast si të tillë. Kjo pasi, fillimisht trajtimi i këtij rasti nga pranimi i kallëzimit penal tregon për neglizhencë të theksuar të PSh-së, pra duke mos e trajtuar brenda 30 ditëve kallëzimin penal që nga pranimi i tij ashtu siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale,³⁴ por është dashur të priten mbi 2 vite për të nxjerrë një aktvendim për fillim të hetimeve e mbi katër (4) vite për ngritje të aktakuzës.

Mosndërmarrja e veprimeve me kohë nga Prokurori i Shtetit, kufizon kohën e gjykatës që brenda afatit të parashkrimit të një rasti, të marrë një vendim meritor.

7.2. Vendosja në prag të parashkrimit pamundëson atakimin në Supreme

IKD në raportin “Parashkrimi i korrupsionit”, kishte evidentuar se gjatë vitit 2023 rrezikonin të parashkruheshin rastet e 24 të akuzuarve, të cilët bënë pjesë në 18 raste gjyqësore. Por që gjatë vitit 2023 janë parashkruar rastet e tetë (8) të akuzuarve të cilët janë të përfshirë në gjashtë (6) raste gjyqësore. Ndërsa, për 16 të akuzuar rastet e tyre nuk ishin parashkruar, ashtu që gjykatat e shkallës së parë kishin shpallur aktgjykimet ende pa arritur parashkrimi, e vendimet e tyre ishin bërë të plotfuqishme edhe nga Apeli. Pas vendimit të Apelit, këto raste kishin arritur afatin e parashkrimit, duke pamundësuar kështu ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme në Gjykatën Supreme.

Përkundër se në këto raste është arritur vendimmarrja meritorë dhe rastet nuk janë parashkruar, vendosja në prag të parashkrimit ka qenë problematike. Kjo vendosje në prag të parashkrimit pamundësoi marrjen e një vendimi nga Gjykata Supreme, pasi asnjë procedurë nuk mund të vazhdohet në momentin kur arrin afati i parashkrimit, ose të paktën edhe nëse do të dërgohej në Supreme rasti, efekti do të ishte i njëjtë. Rast ilustrues për këtë është rasti “Afera e Hidrocentraleve”, ku për këtë rast akuzoheshin Besim Beqaj, Mimoza Kusari-Lila, Dardan Gashi, Nenad Rashiq dhe Fllanza Hoxha. Ky rast rrezikonte të parashkruhej më 8 maj 2023, por vendimi i Themelores ishte marrë me 8 nëntor 2023, ndërsa ishte vërtetuar nga Apeli, më 27 mars 2023, pra dy (2) muaj para arritjes së afatit të parashkrimit.

33 “Deklarohet i pafajshëm zyrtari i prokurimit në Mitrovicë, i akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 26 tetor 2023. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-zyrtari-i-prokurimit-ne-mitrovice-i-akuzuar-per-korrupsion/?fbclid=IwAR2ZAvJ8vT_VsPMeO6jw7AMlt-EQnCrTE1P-24qxb5jL2WiqI-EHHI1_Unk). (Qasur për herë të fundit më 13 nëntor 2023).

34 Shënim: Neni 84 par 1 i Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale “Brenda 30 ditësh pas pranimit të kallëzimit penal, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim të shkruar me të cilin e hedh kallëzimin penal ose kërkon informacione shtesë në pajtim me nenin 83 të këtij Kodi. Nëse prokurori i shtetit ka kërkuar informacione shtesë, ai nxjerr aktvendim për hedhjen e kallëzimit penal brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e paraqitjes së kallëzimit penal fillestar”.

8. Rekomandime

1. Gjyqtarët t'i trajtojnë me prioritet lëndët e korrupsionit.
2. Të shmangen zvarritjet e paarsyeshme në rastet e politikanëve.
3. Gjyqtarët t'i caktojnë seancat bllok, në atë mënyrë që për një rast të caktuar, të mbahen seancat çdo ditë për një periudhë të caktuar kohore.
4. Të zbatohet dispozita e gjyqtarit zëvendësues në mënyrë që të mos kthehen rastet në pikën zero.
5. Gjyqtarët në rastet kur palët mungojnë pa arsyetim, të zbatojnë masat e parapara me Kodin e Procedurës Penale.
6. Kryetarët e Gjykatave të marrin për bazë rastet që rrezikojnë parashkrimin në këtë raport dhe të identifikojnë edhe rastet tjera, në mënyrë që të mos lejojnë parashkrimin.
7. Gjykata e Apelit të shqyrtojë mundësinë që mos të kthejë rastet në rigjykim, por të vendosë në mënyrë meritore.
8. Komisioni për monitorimin e Planeve Strategjike të KGJK-së të monitorojë me theks të veçantë parashkrimin e rasteve të korrupsionit.
9. Autoritetet Kompetente të iniciojnë procedura disiplinore në rastet kur ka bazë se me mosadministrim të mirë nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve një rast i caktuar i korrupsionit ka arritur parashkrimin.

9.Rastet e politikanëve që janë parashkruar dhe që rrezikojnë të parashkruhen 2023-2026



Emri dhe Mbiemri
Xhelal Sveçla

Pozita:
Ministër i Punëve të Brendshme

Vepra Penale:

“Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm”

Faza e procedurës:

Aktgjykim refuzues

Koha e kryerjes:

30.06.2013

Parashkrimi:

30.06.2023



Emri dhe Mbiemri
Valon Ramadani

Pozita:
Deputet i VV-së

Vepra Penale:

“Pengim i Personit Zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare”

Faza e procedurës:

Në proces rasti (Parashkrimi për një vepër penale)

Koha e kryerjes:

21.03.2018

Parashkrimi:

21.03.2024



Emri dhe Mbiemri
Sali Zyba

Pozita:
Deputet i VV-së

Vepra Penale:

“Pengim i Personit Zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare”

Faza e procedurës:

Në proces (Parashkrimi për një vepër penale)

Koha e kryerjes:

21.03.2018

Parashkrimi:

21.03.2024



Emri dhe Mbiemri
Fitore Pacolli-Dalipi

Pozita:
Deputete e VV-së

Vepra Penale:

“Pengim i Personit Zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare”

Faza e procedurës:

Në proces (Parashkrim për një vepër penale)

Koha e kryerjes:

21.03.2018

Parashkrimi:

21.03.2024



Emri dhe Mbiemri
Drita Millaku

Pozita:
Deputete e VV-së

Vepra Penale:

“Pengim i Personit Zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare”

Faza e procedurës:

Në proces (Parashkrim për një vepër penale)

Koha e kryerjes:

21.03.2018

Parashkrimi:

21.03.2024



Emri dhe Mbiemri
Xhavit Haliti

Pozita:
Deputet i PDK-së

Vepra Penale:

“Sulm”

Faza e procedurës:

Në proces në Shkallë të parë

Koha e kryerjes:

18.05.2018

Parashkrimi:

18.05.2024



Emri dhe Mbiemri
Sali Zyba

Pozita:
Deputet i VV-së

Vepra Penale:
“Sulm ndaj Personit Zyrtar”

Faza e procedurës:
Në proces

Koha e kryerjes:
28.08.2015

Parashkrimi:
28.08.2025



Emri dhe Mbiemri
Time Kadrijaj

Pozita:
Deputete e AAK-së

Vepra Penale:
“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Faza e procedurës:
Në proces

Koha e kryerjes:
15.12.2015

Parashkrimi:
15.12.2025



Emri dhe Mbiemri
Albulena Haxhiu

Pozita:
Ministre e Drejtësisë

Vepra Penale:
“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Faza e procedurës:
Rigjykim

Koha e kryerjes:
19.02.2016

Parashkrimi:
19.02.2026



Emri dhe Mbiemri
Pal Lekaj

Pozita:
Deputet i AAK-së

Vepra Penale:
“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Faza e procedurës:
Rigjykim

Koha e kryerjes:
19.02.2016

Parashkrimi:
19.02.2026

RASTET E KORRUPSIONIT TË PARASHKRUARA NË VITIN 2023



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Përpilimi i aktakuzës



Parashkrimi i veprës



Dëmi

Emri i të akuzuarit	Koha e veprës penale	Përpilimi i aktakuzës	Parashkrimi i veprës	Dëmi
Bujar Nerjovaj	2011-2013	30.10.2018	21.02.2023	36.143.00
Bujar Nerjovaj	2013	31.12.2019	08.04.2023	104.674.61
Agron Thaqi	2013	31.12.2019	2023	104.674.61
Naim Avdyli	2013	31.12.2019	2023	104.674.61
Zoja Krasniqi	2011-2014	31.01.2018	2023 "Konflikt interesi"	Nuk përcaktohet
Xhabir Zharku	2008-2010	07.10.2020	2023	Nuk përcaktohet
Latif Ibrahimimi	2013	13.11.2018	2023	Nuk përcaktohet
Shaban Gollopeni	09.12.2013	2016	09.12.2023 (parashkruhet)	Nuk përcaktohet

RASTET E KORRUPSIONIT QË RREZIKOJNË TË PARASHKRUHEN NË VITIN 2024



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi

Emri i të akuzuarit	Koha e veprës penale	Faza e procedurës	Parashkrimi i veprës	Dëmi
Sladjan Trajkovic	13.10.2014	Vendim i Shkallës së parë	13.10.2024	58.021.47€
Fatmir Pireva	2012-2014	Vendim i Shkallës së parë	2024	3.738.88€
Behxhet Hasani	2012-2014	Vendim i Shkallës së parë	2024	3.738.88€
Rrahim Osmani	2012-2014	Vendim i Shkallës së parë	2024	3.738.88€
Sadik Paçarizi	10.02.2014	Rigjykim	10.02.2024	104.674.61€
Nijazi Kryeziu	30.05.2014	Rigjykim	30.05.2024	104.674.61€
Zeqir Gashi	21.02.2014	Shqyrtim Gjyqësor	21.02.2024	53.000.00€
Qazim Reqica	21.02.2014	Shqyrtim Gjyqësor	21.02.2024	53.000.00€
Rexhep Gashi	21.02.2014	Shqyrtim Gjyqësor	21.02.2024	53.000.00€
Agron Hajrizi	21.02.2014	Shqyrtim Gjyqësor	21.02.2024	53.000.00€
Dukagjin Emërllahu	Janar 2014	Shqyrtim Gjyqësor	Janar 2024	Nuk përcaktohet
Mobere Hyseni	30.05.2014	Vendim i Shkallës së parë	30.05.2024	Nuk përcaktohet
Agron Limani	20.03.2018	Shqyrtim Gjyqësor	20.03.2024	5.000€
Salih Kqiku	22.10.2014	Vendim i Shkallës së parë	22.10.2024	358.437.91€
Hatixhe Përzhella	27.05.2014	Vendim i Shkallës së parë	27.05.2024	Nuk përcaktohet
Fadil Rexhepi	Nëntor 2014	Vërtetim i dënimit	Nëntor 2024	Nuk përcaktohet
Remzi Bislimi	Nëntor 2014	Vërtetim i dënimit	Nëntor 2024	Nuk përcaktohet
Nezir Aliu	12.06.2014	Rigjykim	12.06.2024	Nuk përcaktohet
Zoja Krasniqi	2011-2014	Shqyrtim Gjyqësor	2024	Nuk përcaktohet
Haxhimet Ferati	19.11.2014	Shqyrtim Gjyqësor	19.11.2024	Nuk përcaktohet

RASTET E KORRUPSIONIT QË RREZIKOJNË TË PARASHKRUHEN GJATË VITEVE

2025-2026



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi

Emri i të akuzuarit	Koha e veprës penale	Faza e procedurës	Parashkrimi i veprës	Dëmi
Almir Saiti	22.10.2015	Vendim i Shkallës së parë	22.10.2025	Nuk përcaktohet
Muhamet Bajrami	22.10.2015	Vendim i Shkallës së parë	22.10.2025	Nuk përcaktohet
Enver Franca	Janar 2015	Vendim i Shkallës së dytë	Janar 2025	Nuk përcaktohet
Maxhun Maloku	2015	Vendim i Shkallës së dytë	2025	Nuk përcaktohet
Egzon Hyseni	Prill 2019	Vendim i Shkallës së dytë	Prill 2025	2.500.00€
Gani Bajraktari	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Daut Gorani	2011-2015	Shqyrtim Gjyqësor	2025	11.430.00 €
Hamza Selmani	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Ismail Avdimetaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Aferdita Selmanaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Sali Shala	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Nexhat Rexhepaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Agron Besimi	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Bajram Mziu	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Petrit Ademaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Agron Leka	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Driton Miftari	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Besim Gruda	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Mirdi Strana	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Shemsedin Shabollari	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Fisnik Hima	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Luan Pazhari	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €

RASTET E KORRUPSIONIT QË RREZIKOJNË TË PARASHKRUHEN GJATË VITEVE

2025-2026



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi


Emri i të akuzuarit	Koha e veprës penale	Faza e procedurës	Parashkrimi i veprës	Dëmi
Galina Berisha	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Bajram Preteni	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Lulzim Kamberi	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Faik Shatri	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Ejup Pllana	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Florim Sadiku	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Halim Halili	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Agim Krasniqi	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Hajdin Çitaku	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Edmond Haliti	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Besnik Koliqi	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Afrim Poniku	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Banush Gashi	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Nebi Musliu	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Xhevdet Krasniqi	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Dardan Koqinaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Lazer Prekpalaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Rexhep Manaj	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Kelmend Pallaska	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Arlind Batalli	2011-2015	Vendim i Shkallës së parë	2025	11.430.00 €
Masar Gashi	31.12.2015	Shqyrtim Gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Murat Abazi	31.12.2015	Shqyrtim Gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet

RASTET E KORRUPSIONIT QË RREZIKOJNË TË PARASHKRUHEN GJATË VITEVE

2025-2026



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi


Emri i të akuzuarit	Koha e veprës penale	Faza e procedurës	Parashkrimi i veprës	Dëmi
Elfedin Muhaxheri	31.12.2015	Shqyrtim Gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Nexhmi Zeqiri	31.12.2015	Shqyrtim Gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Ferid Susuri	31.12.2015	Shqyrtim Gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Ferihane Sefa	31.12.2015	Shqyrtim Gjyqësor	31.12.2025	Nuk përcaktohet
Selatin Retkoceri	12.10.2015	Vendim i Shkallës së parë	12.10.2025	9.995.77€
Remzi Lumnica	12.10.2015	Vendim i Shkallës së parë	12.10.2025	9.995.77€
Fidan Pacolli	06.05.2015	Vendim i Shkallës së parë	06.05.2025	2.500.00€
Sabri Maliqi	06.05.2015	Vendim i Shkallës së parë	06.05.2025	2.500.00€
Nehat Basha	28.08.2021	Shqyrtim Gjyqësor	28.08.2025	Nuk përcaktohet
Nijazi Kryeziu	31.12.2015	Rigjykim	31.12.2025	7.200.00€
Nexhmije Krasniqi	09.01.2015	Shqyrtim Gjyqësor	09.01.2025	Nuk përcaktohet
Nebi Sheqiri	2016	Vendim i Shkallës së dytë	2026	Nuk përcaktohet
Nazmi Musliu	13.05.2016	Shqyrtim Gjyqësor	13.05.2026	Nuk përcaktohet
Sinan Visoka	15.02.2016	Shqyrtim Gjyqësor	15.02.2026	Nuk përcaktohet
Fitim Veliqi	30.07.2016	Shqyrtim Gjyqësor	30.07.2026	34.176.00
Latif Ibrahim	2016	Vendim i Shkallës së parë	2026	Nuk përcaktohet
Bejtullah Shala	2016	Vendim i Shkallës së parë	2026	Nuk përcaktohet
Bojan Borzanovic	27.08.2016	Shqyrtim Gjyqësor	27.08.2026	Nuk përcaktohet
Besim Zeqiri	19.05.2016	Shqyrtim Gjyqësor	19.05.2026	Nuk përcaktohet
Muharrem Haliti	19.05.2016	Shqyrtim Gjyqësor	19.05.2026	Nuk përcaktohet
Artan Ferati	01.04.2016	Rigjykim	01.04.2026	Nuk përcaktohet
Besnik Beshi	01.04.2016	Rigjykim	01.04.2026	Nuk përcaktohet

RASTET E KORRUPSIONIT QË RREZIKOJNË TË PARASHKRUHEN GJATË VITEVE

2025-2026



Emri i të akuzuarit



Koha e veprës penale



Faza e procedurës



Parashkrimi i veprës



Dëmi

Emri i të akuzuarit	Koha e veprës penale	Faza e procedurës	Parashkrimi i veprës	Dëmi
Xhelil Bekteshi	2016	Vendim i Shkallës së parë	2026	Nuk përcaktohet
Besim Tahiri	2016	Vendim i Shkallës së parë	2026	Nuk përcaktohet
Zekirja Shabani	2016	Shqyrtim Gjyqësor	2026	Nuk përcaktohet
Xhevat Lajçi	01.03.2016	Vendim i Shkallës së dytë	01.03.2026	Nuk përcaktohet
Liridon Hashani	01.03.2016	Vendim i Shkallës së dytë	01.03.2026	Nuk përcaktohet
Emri Lladrovci	30.03.2016	Shqyrtim Gjyqësor	30.03.2026	Nuk përcaktohet
Jakup Tërnavë	22.08.2016	Shqyrtim Gjyqësor	22.08.2026	Nuk përcaktohet
Liridona Mustafa Sadiku	17.10.2016	Shqyrtim Gjyqësor	17.10.2026	Nuk përcaktohet
Bedri Duraku	Korrik 2016	Vendim i Shkallës së parë	Korrik 2026	Nuk përcaktohet
Veton Prekazi	Dhjetor 2016	Shqyrtim Gjyqësor	Dhjetor 2026	Nuk përcaktohet
Naim Shasivari	07.12.2016	Shqyrtim Gjyqësor	07.12.2026	Nuk përcaktohet
Deme Dashi	14.11.2016	Vendim i Shkallës së dytë	14.11.2026	Nuk përcaktohet
Haki Kartallozi	18.10.2016	Vendim i Shkallës së dytë	18.10.2026	18.275.98€
Ilir Baldedaj	31.12.2016	Vendim i Shkallës së dytë	31.12.2026	72.898.98€
Arian Idrizaj	2010	Shqyrtim Gjyqësor	2026	Nuk përcaktohet
Nikola Nojkiq	Gusht 2015 Maj 2016	Vendim i Shkallës së parë	Maj 2026	10.390.50€
Mirdi Strana	30.06.2015	Shqyrtim Gjyqësor	30.06.2025	14.482.25€
Ixhmet Rexhepi	30.06.2015	Shqyrtim Gjyqësor	30.06.2025	14.482.25€
Zahir Musa	30.06.2015	Shqyrtim Gjyqësor	30.06.2025	14.482.25€
Rrahim Merovci	30.06.2015	Shqyrtim Gjyqësor	30.06.2025	14.482.25€
Fatime Zeneli	30.06.2015	Shqyrtim Gjyqësor	30.06.2025	14.482.25€
Bukurije Kushtova	31.03.2016	Shqyrtim Gjyqësor	31.03.2026	Nuk përcaktohet